



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

GJ.A.nr.113/23

KRYETARI I GJYKATËS THEMELORE NË PEJË, Armend Berisha, në mbështetje të nenit 13 par.2 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr.06/L-054), nenit 5 të Rregullores Nr.07/21 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore dhe Degët e Tyre, si dhe në përputhje me Vendimet e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë GJ.A.nr.105/23, GJ.A.nr.106/23, GJ.A.nr.107/23, GJ.A.nr.108/23, GJ.A.nr.109/23, GJ.A.nr.110/23, GJ.A.nr.111/23 dhe GJ.A.nr.112/23, të gjitha të datës 25.04.2023, me datë 25.04.2023 merr këtë:

V E N D I M

Mbi Ndryshimin e Planit Vjetor të Punës për vitin 2023

Plani Vjetor i Punës së Gjykatës Themelore në Pejë për vitin 2023, **NDRYSHOHET** si në vijim:

- I. **NDRYSHOHET neni 5 par.1** ashtu që tani e tutje do të jetë “Në Gjykatën Themelore në Pejë – Selia, janë sistemuar njëzetënjë (21) gjyqtarë të cilët do të punojnë në kuadër të Departamenteve dhe Divizioneve si në vijim”
- II. **NDRYSHOHET neni 5 par.6** ashtu që tani e tutje do të jetë “Në Divizionin Civil do punojnë tetë (8) gjyqtar” dhe shtohen pikat “6.5 Genc Hoxha 6.6. Vegim Maloku dhe 6.7. Rajmonda Kurteshi”
- III. **NDRYSHOHET neni 5 par.7** ashtu që tani e tutje do të jetë “Në Departamentin e Përgjithshëm Penal do të punojnë tre (3) gjyqtar” dhe shtohet pika “7.3 Ilda Cucovic Sahatçiu.”
- IV. **NDRYSHOHET neni 12 par.4** ashtu që shtohet pika “4.3 Ilda Cucovic Sahatçiu.”
- V. **NDRYSHOHET neni 12 par.6** ashtu që shtohet pika “6.4 Vegim Maloku.”
- VI. **NDRYSHOHET neni 12 par.7** ashtu që tani e tutje në vend të “gjyqtari Armend Berisha” do të jetë “ gjyqtari Genc Hoxha”, si në vijim:

“Lëndët që i ndahen gjyqtarëve në Divizionin Civil janë lëndët kontestimore dhe statusore. Ndërsa lëndët jashtëkontestimore dhe përmbarimore i ndahen gjyqtarit Genc Hoxha, në rast të përjashtimit të gjyqtarit Genc Hoxha, lënda e tillë do t’i ndahet gjyqtarit Musë Povataj.”

- VII. **NDRYSHOHET neni 13 par.4** ashtu që shtohet “Pajtesa Boshnjaku – Divizioni Civil.”
- VIII. **NDRYSHOHET neni 13 par.5** ashtu që shtohet “ Arbnor Tmava – Divizioni Civil” dhe “ Fllanza Hashani – Divizioni Civil.”
- IX. **NDRYSHOHET neni 13 par.6** ashtu që shtohet “Armend Lokaj – Departamenti Penal.”
- X. Pjesa tjetër e Planit Vjetor të Punës së Gjykatës për vitin 2023, mbetet e pandryshuar.

A r s y e t i m

Me Vendimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë GJA.nr.105/23, të datës 25.04.2023, gjyqtari Armend Lokaj, pas përfundimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë të Republikës së Kosovës në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm Penal të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Deçan. Me Vendimin GJA.nr.106/23, të datës 25.04.2023, gjyqtarja Fllanza Hashani, pas përfundimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë të Republikës së Kosovës në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë. Me Vendimin GJA.nr.107/23, të datës 25.04.2023, gjyqtari Arbnor Tmava, pas përfundimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë të Republikës së Kosovës në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë. Me Vendimin GJA.nr.108/23, të datës 25.04.2023, gjyqtarja Pajtesa Boshnjaku, pas përfundimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë të Republikës së Kosovës në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog. Me Vendimin GJA.nr.109/23, të datës 25.04.2023, gjyqtarja Ilda Cucovic Sahatçiu, pas përfundimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë të Republikës së Kosovës në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm Penal të Gjykatës Themelore në Pejë. Me Vendimin GJA.nr.110/23, të datës 25.04.2023, gjyqtari Genc Hoxha, pas përfundimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë të Republikës së Kosovës në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm Civil të Gjykatës Themelore në Pejë. Me Vendimin GJA.nr.111/23, të datës 25.04.2023, gjyqtari Vegim Maloku, pas përfundimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë të Republikës së Kosovës në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Pejë dhe me Vendimin GJA.nr.112/23, të datës 25.04.2023, gjyqtarja Rajmonda Kurteshi pas përfundimit të trajnimit fillestar për gjyqtarë të Republikës së Kosovës në Akademinë e Drejtësisë, është caktuar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil të Gjykatës Themelore në Pejë.

Pas këtij ndryshimi, Kryetari i Gjykatës me qëllim të organizimit të punëve dhe zgjidhjen më efikase të lëndëve, gjen se Plani i Punës për vitin 2023 duhet të ndryshohet në përputhje me vendimet e lartcekura andaj, në mbështetje të nenit 13 par.2 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr.06/L-054), nenit 5 të Rregullores Nr.07/21 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën Themelore dhe Degët e Tyre, si dhe në përputhje me Vendimet e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë GJA.nr.105/23, GJA.nr.106/23, GJA.nr.107/23, GJA.nr.108/23,

GJ.A.nr.109/23, GJ.A.nr.110/23, GJ.A.nr.111/23 dhe GJ.A.nr.112/23, të gjitha të datës 25.04.2023, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, GJ.A.nr.113/23, me datë 25.04.2023

Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë

Armend Berisha



Vendimi i dorëzohet:

1. *Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
2. *Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*
3. *Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës*
4. *Gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Pejë*
5. *Administratorit të Gjykatës Themelore në Pejë*